

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5794
E enjte, 6 qershor 2019
çmimi 0.40 €

Në hotelet e Kosovës
për tre muaj qëndruan
65 mijë vizitorë | FAQE 9



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

**UKSHIN HOTI NË LUFTË QË
NJË POPULL I NDARË TË
RRESHTOHET NË RRUGËN E
PËRPARIMIT DHE BASHKIMIT**

F. 10

Prof. dr. Hakif
BAJRAMI



**GJENOCIDI
DHE TERMI
'ZHUKJE'** F.08

Shkruan: Bardhyl
MAHMUTI



**BISEDIME
PO, POR
KOMPROMIS
TË RI JO!** F.08

Jakup KRASNIQI



AKTUALE



**NDËRROI JETË ALBERT
ROHAN, VLERËSOHET
KONTRIBUTI I TIJ PËR
KOSOVËN** F. 7

**HARADINAJ SOT TAKOHET
ME MERKELIN** F. 8

EKONOMI


**AEROPORTI SHËNON DITËN E
MJEDISIT ME MOTON 'PLASTIC
FREE AIRPORT'** F. 9

KULTURË

HAPET PANAIRI I LIBRIT F. 11

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKËLZEN MALIQI

Merkeli do t'i ofrojë siguri Haradinajt për intencat e veta të mira

 | FAQE 4-5

**- Takimi i Haradinajt me kancelaren Merkel,
aktiviteti më i rëndësishëm gjatë mandatit të tij**

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka vlerësuar se takimi i kryeministrit Ramush Haradinaj me kancelaren Angela Merkel do të jetë një nga aktivitetet më të rëndësishme gjatë mandatit të tij. Ai ka thënë se Merkel do t'i japë garanci Haradinajt për intencat e veta të mira. Në këtë

intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Maliqi ka vlerësuar se ky takim organizohet në kuadër të përpjekjeve intensive diplomatike për Samitin e Parisit. Sipas tij, në Paris synohet të sigurohet gjetja e formulës për vazhdimin e dialogut të ndërprerë Kosovë - Serbi. Maliqi ka thënë se

është optimist sa i përket mundësisë që në Paris të vendoset bazamenti i marrëveshjes përfundimtare sepse, sipas tij, konkretizimi i marrëveshjes do të jetë gjë e vështirë meqë Serbia nuk është në gjendje të zotohet hapur për njohjen e pavarësisë së Kosovës

Shtohet optimizmi për liberalizim të vizave

 | FAQE 3

Liderët institucionalë kanë thënë se institucionet e BE-së do ta marrin shumë shpejt vendimin për liberalizim të vizave për Kosovën. Sipas tyre, qytetarët e Kosovës meritojnë të lëvizin lirshëm në Evropë pasi janë përmbushur të gjitha

kushtet. Optimistë janë shprehur edhe njohësit e integritimit evropian. Ata kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" se vendimtar për këtë çështje do të jetë takimi i Parisit në të cilin do të marrin pjesë udhëheqësit e Kosovës



**Rreth 300 infermierë ikën nga
Kosova këtë vit** | FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Vllado Zmajeviq dënohet me 14 vjet burgim për krime lufte në Kosovë

PODGORICË, 5 QERSHOR - Gjykata e Lartë në Podgoricë e ka dënuar Vllado Zmajeviqin me 14 vjet burg për krime lufte kundër popullatës civile në Kosovë. Ai u shpall fajtor për vrasjen e katër civilëve shqiptarë në fshatin Zhegër të Gjilanit në vitin 1999. Kryetari i trupit gjykues, Dragoje Jovoviq, në shpjegimin e aktgjykimin të tij, deklaroi se dësh-

mitë e paraqitura padyshim që "vërtetuan se krimet e luftës janë kryer, pasi për ato kanë dëshmuar dëshmitarët, por edhe vetë i akuzuari e ka pranuar në fazën e parë hetimore, por më vonë i ka mohuar ato deklarata". Zmajeviqi ka të drejtë të apelojë aktgjykimin në Gjykatën e Apelit. Në gusht të vitit 2016, Prokuroria Speciale e Mali të Zi për Krim të

Organizuar dhe Krime Lufte konfirmoi se kishte arrestuar Vllado Zmajeviqin (47 vjeç) nga Nikshiqi, me dyshimin se "ka kryer krime lufte kundër popullatës civile në Kosovë më 1999". Drejtori i Fondit për të Drejtën Humanitare në Kosovë, Bekim Blakaj i kishte thënë "Radios Evropa e Lirë", se Vllado Zmajeviq ishte i pari në listë për

krimet në Zhegër të Gjilanit. Në bazë të hulumtimeve gjatë vitit 2000, Fondi ka dokumentuar se në këtë krim janë vrarë gjashtë persona, më 29 dhe 30 mars 1999. "Në bazë të dëshmimeve të dëshmitarëve, më 29 mars 1999, tetë autobusë, sipas të gjitha gjasave, me vullnetarë të Ushtrisë jugosllave, kanë arritur në fshat dhe kanë vrarë gjashtë



persona. Natyrisht, të gjithë civilë të përkatësisë shqiptare, në mesin e të cilëve edhe pleq dhe gra", kishte deklaruar Blakaj.

Palmeri: Nuk vendosim afate e as vija të kuqe në bisedimet Kosovë - Serbi

ShBA-ja nuk vendos vija të kuqe në procesin e bisedimeve dhe nuk kërkon një afat të caktuar për arritjen e një marrëveshjeje për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Zëvendësndihmëssekretari amerikan i Shtetit, Mathew Palmer, ka thënë se



WASHINGTON, 5 QERSHOR - Zëvendësndihmëssekretari amerikan i Shtetit, Mathew Palmer, ka thënë se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të vazhdojë sa më shpejt. Ai ka thënë se Shtetet e Bashkuara nuk kërkojnë një afat të caktuar për arritjen e një marrëveshjeje për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Shtetet e Bashkuara nuk vendosin vija të kuqe në procesin e

bisedimeve, por kjo nuk nënkupton se të gjitha mundësitë janë të hapura", ka thënë Palmeri në një intervistë për programin në gjuhën serbe të "Zërit të Amerikës". "Ajo çfarë ne do të dëshironim të shikonim është një marrëveshje me autorësi lokale, një marrëveshje e qëndrueshme, një marrëveshje e drejtë, një marrëveshje e zbatueshme dhe që mund të pranohet nga publiku i të dyja palëve, që mund të zbatohet


het drejt dhe plotësisht, dhe një marrëveshje që mund ta çelë rrugëtimin drejt të ardhmes evropiane", ka thënë Palmeri. Duke folur për çështjen e tarifës ndaj mallrave serbe, e cila është arsye që pala serbe ka ndërprerë bisedimet për normalizimin e

raporteve me Kosovës, Palmeri ka thënë se Shtetet e Bashkuara mbështesin heqjen e tarifës nga ana e autoriteteve të Kosovës. "Ne besojmë se interesat e Kosovës shërbejnë më mirë me arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse me Beogradin dhe për të arritur

atë marrëveshje, ata duhet të kthehen te dialogu dhe për të arritur te dialogu, është e rëndësishme që tarifat të eliminohen si një pengesë për përparim", është shprehur Palmeri. Ai ka thënë se ne nuk po kërkojmë ndonjë kuadër kohor të caktuar. "Ne mbështesim normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, ne duam të shohim që dialogu për arritjen e këtij synimi të rifillojë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe që palët të arrijnë një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve në kohë. Nëse kjo do të ndodhë apo jo deri në fund të vitit, nuk jam në gjendje ta parashikoj", ka thënë Mathew Palmer.

Ministri Cakaj ndërron 50 diplomatë shqiptarë

TIRANË, 5 QERSHOR - Pas shkarkimit të 28 diplomatëve dy muaj më parë Gent Cakaj, ministër në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në emër të asaj që i ka quajtur objektiva madhore të diplomacisë dhe reformimit të brendshëm, ka njoftuar për "fshesën" e radhës në këtë ministri. "Sot komunikoj para jush vendimin për largimin nga detyra, ndryshimin e funksioneve në detyrë apo transferimin e menjëhershëm prej angazhimeve aktuale të më tepër se 50 diplomatëve



shqiptarë", tha ai. Ministri Cakaj ka dhënë arsyet përse ka ndërmarrë këtë opera-

cion të dytë spastrimesh. "Disa prej tyre për shkaqe disiplinore, disa prej tyre për

tejkallim të kompetencave, shpërfillje të detyrave në punë apo veprim në shpërputhje me normat diplomatike", është shprehur Cakaj. "Fortuna e shkarkimeve Cakaj" do të vijojë edhe me konsullatat. "80 për qind e konsullatave nëpër botë nuk do të jenë më të njëjta. Ato duhet të ndryshojnë rrënjësisht për shkaqe strukturore dhe për nevojën e rritjes së shërbimeve", ka thënë Cakaj. Ministri Cakaj ka lëshuar një tjetër paralajmërim për mba-

jtësit e pasaportave diplomatike. "Në mbledhjen e ardhshme të qeverisë, mbi 50 për qind e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit do të shpallen të pavlefshme dhe do të jenë jashtë funksionit. Këtu kujtoj, për të gjithë ju, se numri i pasaportave diplomatike të Shqipërisë dhe numri i pasaportave të Shërbimit të Shqipërisë shkon mbi 2500 dhe kjo është jo vetëm në norma të papranueshme, por në fakt, është një praktikë e pabesueshme", është shprehur Cakaj.

Ahmeti i quan shaka 'bisedat e përgjuara' në Maqedoni

SHKUP, 5 QERSHOR - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integritim (BDI), Ali Ahmeti, i ka quajtur "brymë mëngjesi", bisedat e përgjuara telefonike, që po publikohen tash e një kohë nga një person nga Kërçova, por me vendbanim në Çikago të Shteteve të Bashkuara, me nofkën "EL Cheka".

Bisedat e publikuara, protagonist kryesor kanë kreun e BDI-së, Ali Ahmeti dhe bashkëpunëtorët e tij të afërt, të cilët kryesisht komentojnë e etiketojnë zyrtarët e kësaj partie, por edhe zhvillime tjera që kanë të bëjnë me rastet si "Lagja e Trimave", të luftimeve në Kumanovë në vitin 2015, pastaj rastin "Monstra" të vrasjes së pesë të

rinjve maqedonas në vitin 2012, si dhe rastin "Brodeci", një incident në rajonin e Tetovës në vitin 2007 i cili po ashtu kishte përfunduar me viktima. Ahmeti ka thënë se nuk i ka dëgjuar "bombat", siç njihen në opinionion bisedat e përgjuara telefonike, por nga ajo që i kanë treguar bashkëpunëtorët e tij, bëhet fjalë për biseda private

që, ai i ka quajtur, "shaka". "Nuk i kam dëgjuar bisedat e përgjuara, sepse nuk kam vesh për shaka...kjo është brymë e mëngjesit edhe këto do të ikin sepse njerëzit nuk merren me gjëra të kota... organet e drejtësisë duhet të merren me këto biseda të përgjuara dhe të njëjtat nuk duhet të përdoren në tregun e zi. Le t'i publikojnë



bisedat tona zyrtare. Pse nuk bëhet kjo, por, jepen gjëra të kota", ka deklaruar Ahmeti.

Bëhet thirrje që procesi i liberalizimit të vizave mos të zvarritet

Shtohet optimizmi për liberalizim të vizave

Liderët institucionalë kanë thënë se institucionet e BE-së do ta marrin shumë shpejt vendimin për liberalizim të vizave për qytetarët e Kosovës. Sipas tyre, qytetarët e Kosovës meritojnë të lëvizin lirshëm në Evropë pasi janë përmbushur të gjitha kushtet. Optimistë janë shprehur edhe njohësit e integritimeve evropiane. Ata kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" se vendimtar për këtë çështje do të jetë takimi i Parisit në të cilin do të marrin pjesë udhëheqësit e Kosovës

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Liderët institucionalë presin që shumë shpejt të ndodhë liberalizimi i vizave për Kosovën dhe të mbyllet etapa e izolimit të shtetit të Kosovës. Edhe njohësit e integritimeve evropiane kanë shprehur optimizëm në këtë drejtim, duke thënë se vendimtar për këtë proces do të jetë Samiti i Parisit, i cili do të mbahet në fillim të korrikut.

Presidenti Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, sërish ka deklaruar se vendi ynë është duke u diskriminuar nga Bashkimi Evropian (BE) në raport me liberalizimin e vizave. Të mërkurën, gjatë një aktiviteti me të rinjtë në Prishtinë, në kuadër Ditës Botërore të Sportit dhe Mjedisit, ai ka thënë se liberalizimi i vizave duhet të ndodhë shumë shpejt, në mënyrë që të rinjtë e Kosovës të lëvizin lirshëm nëpër vendet evropiane. "Le të mbetet kjo ditë e optimizmit për të ardhmen e rinisë së Kosovës, natyrisht duke ndodhur edhe liberalizimi i vizave shpejt, në mënyrë që të mos mbetet vendi i izoluar, të mos mbesin gjithë këta të rinj të izoluar për të mos marrë pjesë në garat ndërkombëtare dhe të përmbillet ky diskriminim dhe izolim për të rinjtë e Kosovës dhe shtetin e Kosovës", ka thënë Thaçi.

Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj është shprehur i bindur për liberalizim të vizave pas takimit të fundit që ka pasur me ministrin e brendshëm gjerman. Madje, sipas kryeministrit, urgjenca për liberalizim të

në këtë drejtim", ka thënë Haradinaj në takimin e Këshillit Ministror për Integritim Evropian.

Njohësit e integritimeve evropiane: Të punohet me secilin shtet të BE-së

Edhe njohësit e integritimeve evropiane besojnë se më nuk ka asnjë arsye që të zvarritet liberalizimi i vizave për Kosovën. Megjithatë, ata kanë thënë se duhet të hiqen edhe disa dilema për vendet anëtare të BE-së. "Jam optimist dhe besoj në deklarin e evropianeve, se pas zgjedhjeve nuk ka më arsye logjike për ta prolonguar edhe më tutje këtë vendim. Megjithatë, rezervat e mia do të hiqeshin sikur të tregoheshim edhe pak më aktivë në kuptimin e heqjes së çfarëdo dileme që vendet e BE-së do të mund të kishin kundrejt Kosovës. Ne vazhdimisht themi se i kemi përmbushur kriteret dhe me

pjesën më të madhe të kësaj pajtohemi edhe unë, por është i nevojshëm një koordinim më i ngushtë i institucioneve tona me secilin shtet të BE-së në mënyrë që të merren, para së gjithash, shqetësimet e tyre", ka thënë për gazetën "Epoka e re" profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti. Sipas tij, duhet të llobohet edhe më shumë te disa vende. "Për shembull, të bisedohet me Francën se cili është shqetësimi i francezëve, nëse është migracioni ilegal ta kthenim atë në detyrë, të hartonim raporte dhe t'u dërgonim francezëve se kemi përmbushur jo vetëm në mënyrë deklarative, por edhe në praktikë të gjitha kriteret në mënyrë që ky vendim të merret sa më shpejt që është e mundur. Nuk do të befasohesha që një gjë e tillë të ndodhte në qershor", është shprehur ai. Kurse drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka bërë me dije se Samiti i Parisit do të jetë i

rëndësishëm për procesin e liberalizimit të vizave dhe për dialogun Kosovë - Serbi. "Takimi me Merkelin do t'i shërbejë Kosovës për ta përgatitur Samitin e Parisit, por edhe për ta adresuar agjendën e saj të integritimeve evropiane, veçanërisht liberalizimin e vizave. Derisa nga Samiti i Francës besoi se do të jetë një pikë kthese nga dy shtetet për t'iu rikthyer tryezës së dialogut, përmes së cilës do të synohet potencialisht arritja e një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjrisht të obligueshme", ka thënë Kryeziu.

Në raportin e fundit për Kosovën, Komisioni Evropian ka ripërsëritur qëndrimin se Kosova ka përmbushur kriteret për liberalizimin e vizave. Megjithatë, raporti ka ftuar institucionet e Kosovës ta vazhdojnë përmbushjen e kriterëve që dalin nga udhërrëfyti për liberalizimin e vizave, me theks të veçantë në sundimin e ligjit dhe migrimin.



Haradinaj sot takohet me Merkelin

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Të mërkurën ka mbërritur në Berlin kryeministri Ramush Haradinaj së bashku me zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Behgjet Pacollit. Haradinaj sot (e enjte) do të ketë një takim me kancelaren gjermane Angela Merkel dhe kryetarin e Bundestagut, Wolfgang


Schauble, deputetë të të gjitha grupeve parlamentare në Bundestag. Ai do të marrë pjesë në konferencën "Takimet ndërkombëtare" dhe do të jetë pjesë e Lutjeve të Mëngjesit në Berlin. "Kjo vizitë pune do të ketë për qëllim thellimin e marrëdhënieve dhe besimit në mes të Kosovës dhe Gjermanisë si partnere strategjike.

Bashkëpunimi i bazuar në besim është i domosdoshëm në rrugëtimin e Kosovës për zhvillim ekonomik, integritime evropiane dhe në fushën e sigurisë. Gjermania vazhdon të jetë një ndër partnerët kryesor të Kosovës dhe përkrahja e saj është jetike për arritjen e objektivave tona të përbashkëta", ka thënë Haradinaj.



Flet për "Epokën e re", Shkëlzen Maliqi

Merkeli do t'i ofrojë siguri Harad



- Takimi i Haradinajt me kancelaren Merkel, aktiviteti më i rëndësishëm gjatë mandatit të tij

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka vlerësuar se takimi i kryeministrit Ramush Haradinaj me kancelaren Angela Merkel do të jetë një nga aktivitetet më të rëndësishme gjatë mandatit të tij. Ai ka thënë se Merkeli do t'i japë garanci Haradinajt për intencat e veta të mira. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Maliqi ka vlerësuar se ky takim organizohet në kuadër të përpjekjeve intensive diplomatike për Samitin e Parisit. Sipas tij, në Paris synohet të sigurohet gjetja e formulës për vazhdimin e dialogut të ndërprerë Kosovë - Serbi. Maliqi ka thënë se është optimist sa i përket mundësisë që në Paris të vendoset bazamenti i marrëveshjes përfundimtare sepse, sipas tij, konkretizimi i marrëveshjes do të jetë gjë e vështirë meqë Serbia nuk është në gjendje të zotohet hapur për njohjen e pavarësisë së Kosovës

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Njohësi i proceseve politike, Shkëlzen Maliqi, ka thënë të mërkurën se takimi i kryeministrit Ramush Haradinaj me kancelaren gjermane Angela Merkel është një nga aktivitetet më të rëndësishme gjatë mandatit të tij. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se në këtë takim Merkeli do t'i ofrojë siguri Haradinajt për intencat e veta të mira. "Për kryeministrin Haradinaj vizita në Gjermani dhe takimi me kancelaren Merkel janë aktivitete shumë të rëndësishme, mbase më të rëndësishmet që i ka pasur gjatë mandatit të tij. Vizita organizohet në kuadër të përpjekjeve intensive diplomatike për samitin e radhës më 1 korrik", ka deklaruar Maliqi, duke shtuar se për dallim nga Berlina një muaj më parë, ku nuk u arrit asgjë konkrete, në Paris synohet të sigurohet gjetja e formulës për vazhdimin e dialogut të ndërprerë Kosovë - Serbi.

Megjithatë, ai ka thënë se është optimist sa i përket mundësisë që në Paris të vendoset bazamenti i marrëveshjes përfundimtare sepse, sipas tij, konkretizimi i marrëveshjes do të jetë gjë e vështirë. "Për shembull, nuk besoj se Serbia sot është në gjendje të zotohet hapur për njohjen e pavarësisë së Kosovës. Kjo do të ishte tepër e rrezikshme për udhëheqësinë e saj aktuale. Por, ajo mund të obligohet që në afatin e caktuar, për shembull brenda gjashtë muajve, të organizohet referendumi për ndryshimin e Kushtetutës të Serbisë, të atyre pjesëve që Kosovën e trajtojnë si pjesë të patjetërsueshme të saj. Me këtë vendim do të bartet te qytetarët e Serbisë, jo te presidenti Vuçiq", është shprehur Maliqi. Në këtë intervistë ai ka folur edhe për zhvillimet e fundit në vend, me ç'rast ka thënë se është thyer akulli në raportet mes dy partive kryesore të opozitës, me paralizimin e mocionit për mosbesim ndaj qeverisë Haradinaj dhe lidhjen e koalicionit parazgjedhor

LDK - IV. Sipas Maliqit, kjo premton një vjeshtë dinamike, me pak fat, ndoshta, edhe arritjen e qëllimit që vendi të shkojë drejt zgjedhjeve të parakohshme.

"Epoka e re": Z. Maliqi, kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, sot (e enjte) do të takohet me kancelaren e Gjermanisë, Angela Merkel. Si e shihni këtë takim dhe cilat janë pritjet e juaja në këtë drejtim?

Maliqi: Për kryeministrin Haradinaj vizita në Gjermani dhe takimi me kancelaren Merkel janë aktivitete shumë të rëndësishme, mbase më të rëndësishmet që i ka pasur gjatë mandatit të tij. Vizita organizohet në kuadër të përpjekjeve intensive diplomatike për samitin e radhës më 1 korrik. Për dallim nga Berlina një muaj më parë, ku nuk u arrit asgjë konkrete, në Paris synohet të sigurohet gjetja e formulës për vazhdimin e dialogut të ndërprerë Kosovë - Serbi. Për këtë duhet të zbuten qëndrimet e dy palëve që kushtëzojnë vazhdimin e dialogut. Serbia kërkon heqjen e

inajt për intencat e veta të mira



taksës, kurse Kosova nuk e heq taksën pa njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Beogradi. Tash pyetja është se kush do të tërhiqet nga kushtëzimet? Zakonisht diplomacia, kur bëhet fjalë për qëndrime të papajtueshme, kërkon zgjidhje kompromise, që në këtë rast të pezullohet taksa përkohësisht ose që Serbisë t'i afatizohet njohja e Kosovës për aq sa zgjat pezullimi. Prej kohësh është përfolur për nënshkrimin e një deklarate të përbashkët, të formuluar me kujdes, mbi platformën që ofron mundësinë e pajtimit historik rreth Kosovës, i cili do të bazohet në parimet politike edhe sot të pranueshme nga të dyja palët. Mendoj se tani po punohet të paktën për këtë. Kjo deklaratë do të duhej të ishte politike dhe e afatizuar, kështu që do të hapte rruga për pezullimin e taksës, njëkohësisht edhe rruga për njohjen e pavarësisë së Kosovës nga ana e Serbisë.

"Epoka e re": A besoni se Samiti i Parisit i 1 korrikut mund të sjellë diçka të tillë, madje edhe më konkrete, kështu që dialogu ndërmjet dy vendeve jo vetëm se do të ringjallet, por edhe ta sjellë rezultatin e pritur? Njohësit e proceseve politike dhe ndërkombëtare kanë thënë se në Paris mund të vendoset bazamenti i marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi. A jeni optimist se do të mund të ndodhë kjo?

Maliqi: Po, jam optimist sepse, gjithsesi, ky është qëllimi. Vetëm se konkretizimi i marrëveshjes do të jetë i vështirë. Për shembull, nuk besoj se Serbia sot është në gjendje të zotohet hapur për njohjen e pavarësisë së Kosovës.

Kjo do të ishte tepër e rrezikshme për udhëheqësinë e saj aktuale. Por, ajo mund të obligohet që në afatin e caktuar, për shembull brenda 6 muajve, të organizohet referendumi për ndryshimin e Kushtetutës të Serbisë, të atyre pjesëve që Kosovën e trajtojnë si pjesë të patjetërsueshme të saj. Me këtë peshë e vendimit do të bartet te qytetarët e Serbisë, jo te presidenti Vuçiq. Edhe ashtu pa ndryshimin e Kushtetutës Serbia nuk ka mundësi ta njohë pavarësinë e Kosovës. Dhe një vendim për referendum do të duhej të ishte garanci e mjaftueshme për Haradinajn që ta pezullojë taksën si gjest i vullnetit të mirë për vënien e marrëveshjes historike në veprim.

"Epoka e re": Si e shihni ecurinë e dialogut pas këtij samiti dhe pas zgjedhjeve në BE?

Maliqi: Nëse arrihet pajtimi rreth deklaratës politike, atëherë do të krijohet hapësira për dialog më intensiv për disa çështje të hapura që marrëveshja e Ahtisaarit i ka rregulluar në parim, por duhet të konkretizohen si, për shembull, çështja e asociacionit të komunave me shumicë serbe, statusi i manastireve e disa të tjera. Në dialogun e Brukselit më parë ato janë zgjidhur në parim, por ka mospajtime në interpretime dhe dëshira që të shpërthehet kompromisi bazë i Ahtisaarit. Mendoj se kjo mund të zgjidhet. Dhe nuk është e rastësishme që në të njëjtën kohë kur kryeministri Haradinaj do të takohet me kancelaren Merkel, në Berlin ka udhëtuar edhe një delegacion i Listës Serbe, i cili duhet të bindet rreth procesit. Merkel do t'i ofrojë

siguri Haradinajt për intencat e veta të mira, njëkohësisht ato ua ofron edhe serbëve të Kosovës.

"Epoka e re": Z. Maliqi, si i komentoni zhvillimet në skenën politike, qeverisjen e deritanishme dhe rolin opozitar?

Maliqi: Zhvillimet e fundit janë interesante, është thyer akulli në raportet mes dy partive kryesore të opozitës, me paralajmërimin e mocionit për mosbesim ndaj qeverisë Haradinaj dhe lidhjen e koalicionit parazgjedhor LDK - LV, që premtun një vjeshtë dinamike, me pak fat, ndoshta, edhe arritjen e qëllimit që vendi të shkojë drejt zgjedhjeve të parakohshme. Ky mund të jetë element shtesë motivues për kryeministrin Haradinaj që këtë sfidë ta përballojë duke bërë që Samiti i Parisit të 'punojë' në favor të tij. Sepse vazhdimi i dialogut me një afatizim 6 deri 8 muajor, e bën të parakohshme nismën e opozitës për rrëzimin e qeverisë sepse, nëse hapet rruga për dialog, Kosova nuk mund të jetë njëkohësisht në krizë qeveritare, me fushata që zakonisht më shumë përçajnë sesa bashkojnë spektrin politik. Pra, kryeministri Haradinaj mund të gjendet në situatën kur kërcënohet nga kalimi i ngushticës politike mes Skilës dhe Haribdës, ku për të fituar kohën shtesë për qeverisje i nevojitet ta pajtojë akordin e supozuar të Parisit. Kjo edhe mund të jetë rruga për ngadhënjimin e opsionit të tij të zgjidhjes së krizës në krah të platformës Merkel - Makron, pasi ajo edhe po imponohet si alternativë evropiane e projektit të 'korigjimit' të kufijve.

Rreth 300 infermierë ikën nga Kosova këtë vit

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Që prej fillimit të këtij viti, rreth 300 infermierë kanë ikur nga Kosova për në vendet e Bashkimit Evropian. Këto janë të dhënat e fundit që i ka Federata Sindikale e Shëndetësisë.

Qendra Klinike Universitare e Kosovës si qendër terciare, referente për tërë Kosovën, ka gjithsej 1 900 infermierë të profileve të ndryshme, por që si numër del të jetë i pamjaftueshëm. Ndërkaq, në gjithë sistemin publik shëndetësor janë rreth 6 500 infermierë të punësuar.

Nga Federata Sindikale e Shëndetësisë thonë se për një sistem të mirëfilltë do të duhej edhe punësimi i rreth 4 000 infermierëve për t'i plotësuar nevojat e pacientëve. Përpos këtij numri të infermierëve që tashmë kanë ikur nga Kosova, ka edhe të tjerë që po presin të largohen. Një nga ta është Muhamet Hyseni, i cili,

duke folur për "Radion Evropa e Lirë", thotë se tashmë ka vendosur të ikë për në Gjermani për shumë arsye. Ai thotë se tashmë ka bërë një kontratë me shtetin gjerman.

Naser Rustemi, kryetar i Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë shëndetësorë, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", tha se çdo ditë infermierë të profileve të ndryshme kërkojnë dokumente që dëshmojnë se ata janë infermierë të licencuar nga kjo Odë, e që iu shërben atyre për të punuar jashtë vendit. Megjithatë, ai thotë se nuk kanë statistika se sa infermierë po ikin jashtë Kosovës. Në anën tjetër, Blerim Sylja, kryetar i Federatës Sindikale të Shëndetësisë, tha se, ndonëse po kërkojnë statistika zyrtare nga institucionet relevante për ikjen e stafit mjekësor nga Kosova, një gjë e tillë është e pamundur pasi, siç



thotë ai, po i fshehin numrat e saktë.

Së fundmi në Qendrën Klinike

Universitare të Kosovës janë punësuar 100 infermierë të rinj, por ky numër nuk i ka plotësuar

nevojat që ka ky institucion për stafin e mesëm. Zyrtari për informim, Shpend Fazliu, ka bërë me dije se ky numër është përcaktuar në bazë të mundësive buxhetore që ka pasur ky institucion por, sipas tij, pritet të ketë edhe konkurse të tjera, meqë edhe 100 infermierë të rinj që janë punësuar nuk paraqet numër të mjaftueshëm.

Oda e Infermierëve të Kosovës tashmë është bërë anëtare e Organizatës Botërore të Asociacioneve Ndërkombëtare. Kjo u mundëson infermierëve që t'u njihen licencat jashtë Kosovës, që deri më tani nuk ka qenë. Gjithashtu, kjo Odë ka bashkëpunim të mirë me Slloveninë, pasi tashmë ka edhe memorandum bashkëpunimi qoftë për trajnime të ndryshme apo edhe për edukim të vazhdueshëm profesional për infermierët.

Vazhdon programi 'Vizitat shtëpiake'

Është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit për zgjerimin e vizitave shtëpiake në mes të AMC-së dhe UNICEF-it, program i cili është nën udhëheqjen e Ministrisë së Shëndetësisë



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Fondacioni humanitar "Action for Mothers and Children" përgjatë muajit maj ka filluar partneritetin me organizatën ndërkombëtare UNICEF - programi në Kosovë. Sipas një komunikate të "Action for Mothers and Children", programi i UNICEF-it në Kosovë fokusohet në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve pa dallime, forcimin e kapaciteteve të institucioneve në nivel qendror dhe lokal për të zhvilluar dhe ofruar shërbime cilësore për fëmijët dhe në mbështetjen e fëmijëve, adoleshentëve, vajzave dhe djemve, prindërve dhe komuniteteve për të kërkuar të drejtat e tyre dhe për të marrë pjesë në zhvillimin e komunitetit në mënyrë që çdo fëmijë të ndihet i barabartë.

"Vizitat shtëpiake" është program i Ministrisë së Shëndetësisë

dhe UNICEF-it, program ky i cili synon ofrimin e shërbimeve shtëpiake në komunat e Kosovës si një qasje për të përmirësuar më tej shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve, duke ndërtuar besimin në mes të infermierëve, punonjësve socialë dhe komunitetit për përforsimin e sistemeve të mjekësisë familjare. "Vizitat në shtëpi ndihmojnë familjet në identifikimin e problemeve të të porsalindurit, duke përfshirë shenja të sëmundjeve dhe, në të njëjtën kohë, përkrahen praktikat si të ushqyerit me qumësht të gjirit, vaksinim me kohë dhe të plotë, ne kontribuojmë që fëmija të rritet dhe të zhvillohet më mirë në arritjen e potencialit të plotë të fëmijës", është theksuar në komunikatën e "Action for Mothers and Children".

Më tutje në komunikatë theksohet se "me programin e vizitës në shtëpi, qëllimi ynë i përgjithshëm është rritja e njohurive të stafit

mjekësor, grave shtatzëna dhe nënave të reja në kujdesin antenatal, kujdesit pas lindjes, depresionit pas lindjes, zhvillimi i fëmijës së moshë të hershme (0-3 vjeç), roli i partnerëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes për të ofruar mbështetje, zgjerimin dhe fuqizimin e ofruesve të kujdesit shëndetësor në mbarë

Kosovën përmes programeve të trajnimit dhe angazhimit në aktivitetet arsimore". Në të njëjtën kohë AMC dhe UNICEF do ta implementojnë programin 'ushqyeshmëria e fëmijëve' e cila fokusohet në mjetet, udhëzimet dhe rekomandimet për ushqyeshmërinë e shëndetshme të fëmijëve të cilat

do të zhvillohen, miratohen dhe shpërndahen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe, gjithashtu, do të integrohen në programet mësimore në parashkollorë dhe shkolla fillore, e gjithë kjo me qëllim të krijimit të shprehive të ushqyeshmërisë së shëndetshme të fëmijët.

Ministri Tahiri: Të korruptuarit nuk duhet të ndëshkohen asnjëherë me masa alternative

PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka hapur të mërkurën punimet në seminarin e nivelit të lartë mbi dënimet dhe masat alternative, organizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe projekti i binjakëzimit të BE-së, "Fuqizimi i mëtutjeshëm i Shërbimit Korrektues dhe Sprovues të Kosovës".

Ministri Tahiri ka kërkuar nga gjyqtarët e prokurorët që t'i kushtojnë rëndësi zbatimit të masave alternative, duke qenë se, përveç ndëshkimit, drejtësia synon edhe riintegrimin e personave të dënuar. "Qëllimi i drejtësisë që ne si shoqëri synojmë, përveç ndëshkimit për kryerësit e veprave penale, përveç parandalimit dhe luftimit të dukurive antiligjore,



është që nga ballafaqimi me të, qytetarët tanë të reflektojnë dhe t'i rikthehen shoqërisë së përgatitur për t'i respektuar parimet dhe normat sociale. Ky është, në esencë, qëllimi mbra-

pa masave dhe dënimeve alternative që po i trajtojmë sot", ka thënë Tahiri. Megjithatë, ministri Tahiri ka kërkuar nga gjyqtarët dhe prokurorët që në asnjë rrethanë mos të shqiptojnë

dënime alternative për veprat e korrupsionit. Ministri Tahiri ka theksuar se do ta përkrahë edhe më tutje profesionalizimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në këtë fushë

edhe përmes Agjendës "Drejtësia 2020", në kuadër të së cilës po mbahet edhe ky seminar.

Agjenda "Drejtësia 2020" tashmë ka kredenciale të njohura si plan që do t'i përshpejtojë reformat në sistemin e drejtësisë dhe që ka mbështetjen e plotë të Bashkimit Evropian. "Kjo agjendë në epiqendër e ka përshpejtimin e reformave, zbatimin e tyre dhe fundin e tranzicionit të gjatë në drejtësinë tonë, me synimin e vetëm që qytetarët ta kenë një përvojë të re me sistemin e drejtësisë. Rruga nuk është e lehtë, por absolutisht nuk është e pamundur dhe jemi shumë optimistë se kjo agjendë do ta arrijë ta bëjë dallimin", ka theksuar ministri Tahiri.

Sot në Klinë nis Festivali "I këndojmë lirisë"

KLINË, 5 QERSHOR (ER) - Sot (e enjte) në Klinë nis Festivali Folklorik Mbarëkombëtar "I këndojmë lirisë", i cili do të zgjasë deri më 8 qershor. Sivjet është edicioni 19 me radhë i festivalit që nis në Çabiq, në vendlindjen e Mujë Krasniqit-"Kapuçit", njërit nga komandantët më të shquar të UÇK-së.

Në hapjen solemne të festivalit para kullës muze, me këngë dhe valle do të paraqiten grupe artistësh, rapsodë e instrumentistë nga Kosova dhe Shqipëria. Po ashtu, sivjet bëhet edhe inaugurimi i oborrit të kullës muze, investim i Komunës së Klinës.

Në Çabiq, në nderim të festi-

valit dhe të bashkëshatarit komandant Mujës, do të shtrohet sofrat me ushqime tradicionale. Gjatë mbajtjes së Festivalit Folklorik "I këndojmë lirisë", botohet edhe revista periodike "Lyra", e cila përfshin të gjitha aktivitetet që zhvillohen në kuadër të festivalit.



Ndërroi jetë Albert Rohan, vlerësohet kontributi i tij për Kosovën

Të mërkurën, në moshën 83-vjeçare, ka ndërruar jetë ish-diplomati austriak Albert Rohan, i cili ishte i dërguar i OKB-së në bisedimet për statusin e Kosovës. Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës kanë shprehur ngushëllime për vdekjen e tij, duke vlerësuar lart kontributin e tij për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Diplomati austriak Albert Rohan ka vdekur në moshën 83-vjeçare, ka njoftuar të mërkurën Ministria e Punëve të Jashtme e Austrisë. Rohan së bashku me të dërguarin e Kombeve të Bashkuara, Marti Ahtisari, ka marrë pjesë në negociatat për statusin e Kosovës. "Austria ka humbur njërin prej diplomatëve më të aftë. Për ministrinë dhe mua personalisht, vdekja e Rohanit paraqet humbje të një modeli të madh", ka thënë shefi i diplomacisë austriake, Alexander Schallenberg. Në njoftimin e Ministrisë së Jashtme të Austrisë, thuhet se Rohani në vitet 1990 ka marrë pjesë në hartimin e politikës për Ballkanin, me qëllim të vendosjes së paqes

dhe zhvillimit të një perspektive evropiane në këtë rajon. Rohan i është bashkuar shërbimit diplomatik të Austrisë në vitin 1963 dhe ka shërbyer, mes të tjerash, në ambasadat e Austrisë në Londër dhe Beograd. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se e ka pikëlluar lajmi për vdekjen e ish-ambasadorit Albert Rohan. Ai ka thënë se Albert Rohan si negociator në dialogun për statusin e Kosovës dhe si diplomat austriak ka kontribuar shumë për vendosjen e paqes në rajonin tonë. "Më pikëlloi vdekja e mikut tim dhe të Kosovës, ambasadorit Albert Rohan. Si negociator në dialogun për statusin e Kosovës dhe si diplomat austriak, Albert Rohan kontribuoi shumë për vendosjen e paqes në rajonin tonë. Do ta ruajmë kujtimin për të si një

diplomat shembullor, që bëri shumë për popullin e Kosovës", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook". Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka shprehur ngushëllime për vdekjen e Albert Rohanit. "Sot vdiq një mik imi dhe i Kosovës, Albert Rohan. E kam takuar për herë të parë në vitin 1998. Ky ishte edhe takimi i parë zyrtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me një diplomat nga Evropa. Albert Rohan ishte prej

atyre njerëzve që kontribuuan shumë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. I jemi përjetësisht mirënjohës. Pushoftë në paqe!", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook". Ndërkaq kryeministri Ramush Haradinaj ka theksuar se të mërkurën Kosova ka humbur një mik të saj. "I pikëlluar me rastin e ndarjes nga jeta të ish-diplomatit austriak Albert Rohan, një figurë e shquar që u angazhua për të drejtën e vendit

dhe të popullit tonë e që fuqishëm kundërshtoi çdo cenim të saj. Prehu në paqe mik i Kosovës, Albert Rohan", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Për vdekjen e Rohanit kanë reaguar edhe zëvendëskryeministrat Enver Hoxhaj dhe Fatmir Limaj, të cilët kanë theksuar se vdekja e Rohanit është humbje e madhe jo vetëm për shtetin austriak, por edhe për diplomacinë botërore në përgjithësi.

Bytyqi premtion ndarje të kuotave për studentët shqiptarë nga Mali i Zi



PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka pritur të mërkurën në takim një delegacion të përbërë nga përfaqësues të Këshillit Kombëtar, Ministria e Arsimit dhe Ministria për të Drejtat e Pakicave në Mal të Zi, me të cilët ka biseduar rreth gjendjes së arsimit në gjuhën shqipe në Mal të Zi, për kuotat në universitetet publike të Kosovës për

kandidatët shqiptarë nga Mali i Zi dhe për sigurimin e teksteve shkollore për nxënësit shqiptarë atje. "Përtej dëshirës, Ministria e Arsimit e ka edhe obligim që t'i ndihmojë nxënësit shqiptarë në Mal të Zi në çfarëdo forme dhe për këtë shpreha gatishmërinë time që të gjejme edhe bashkëpunime të reja, me qëllim që të ofrohet arsim më cilësor për nxënësit shqiptarë që jetojnë në Mal të

Zi. Pas kërkesës së delegacionit që të bëhet ndarja e kuotave për studentët shqiptarë nga Mal i Zi, premtova se do të diskutoj edhe këtë vit me Universitetin e Prishtinës mundësinë e realizimit të kësaj kërkesë", ka thënë Bytyqi pas takimit. Ai ka bërë me dije se në këtë takim kanë biseduar edhe për mundësinë e ofrimit të trajnimeve në Kosovë për mesimdhënësit shqiptarë të Malit të Zi.

Prokuroria Speciale: Fotografia e prezantuar nga Brovina për dhunime është nxjerr nga interneti

PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka thënë se ngjarja nga fotografia e paraqitur nga deputetja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Flora Brovina, është nxjerrë nga interneti dhe nuk ka të bëjë me ndonjë rast të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Prokuroria Speciale kishte hapur hetimet, pas paraqitjes së fotografisë nga deputetja Brovina, përmes së cilës ajo pretendonte se po dëshmonte

për një rast dhunimi të një gruaje gjatë luftës së fundit në Kosovë nga ana e forcave serbe. "Fotografia në fjalë është dërguar për ekspertizë në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, e cila ka konstatuar se fotografia e paraqitur nga deputetja Flora Brovina është e printuar në format A4 kolor dhe nuk ka asnjë të dhënë e cila kishte mundësuar hulumtimin e origjinës së fotografisë dhe nuk ka asnjë shenjë nga është printuar. Kjo fotografi është krahasuar me një fotografi tjetër të

siguruar nga interneti dhe u konstatua se në të dy fotografitë është paraqitur ngjarja e njëjtë", është thënë në komunikatën e Prokurorisë Speciale. Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, Flora Brovina, ka publikuar javë më parë në hollin e Kuvendit një fotografi me pamje të rënda grafike, të cilën e ka prezantuar si dëshmi e dhunimit seksual të një gruaje shqiptare nga forcat ushtarake serbe në prani të familjarëve të saj, por ajo doli të jetë fotografi e falsifikuar.



Shkrim drejtuar gazetarëve dhe atyre që merren me politikë

Gjenocidi dhe termi 'zhdukje'



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

Siç u përmend në shkrimet kushtuar përkufizimit të gjenocidit, që të kualifikohet si gjenocid, akti kriminal duhet të jetë kryer me qëllim që të shkatërrohet tërësisht ose pjesërisht një grup i caktuar nacional, etnik, racor ose fetar, si i tillë.

Në rastet kur do të kishim të bënim me shkatërrimin e tërësishtëm të njërit nga grupet e lartpërmendura, debati për kualifikimin e krimin si gjenocid do të mbyllej shpejt. Ndërsa kur kemi të bëjmë me shkatërrimin e pjesëshëm të një grupi të caktuar nacional, etnik, racor ose fetar, mospajtimet janë të mëdha, për arsye se në këtë përkufizim nuk përcaktohet asnjë numër dhe asnjë përqindje në bazë të së cilës shkatërrimi i pjesëshëm i grupeve të lartpërmendura do të mund të kon-

siderohej si gjenocid.

Kur kemi të bëjmë me vrasjet e anëtarëve të grupeve që përcaktohen në definicionin e gjenocidit, e që përbën vetëm njërin nga aktet e gjenocidit [Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimin të Gjenocidit, Neni II, paragrafi (a)], në studimin e publikuar si dokument zyrtar i Kombeve të Bashkuara lidhur me çështjen e parandalimit dhe të dënimit të krimin të gjenocidit theksohet: "përkundër asaj që qëllimi i konventës është parandalimi dhe ndëshkimi i akteve të gjenocidit të drejtuara kundër një numri të madh personash, asgjë nuk e ndalon që këto dispozita të interpretohen dhe të aplikohen në rastin e vrasjeve individuale. Edhe në rastet kur rezultati është vrasja e një personi të vetëm, fakti se qëllimi i kriminelit është drejtuar kundër jetës së më shumë se një anëtarit të grupit nuk paraqet asnjë pengesë që dispozitat e Konventës të aplikohen edhe në këtë rast (United Nations, Economic and Social Council, Nicodème Rughashyankiko, Study of the question of the prevention and the punishment of the crime of genocide, f. 15).

Megjithatë, një numër i konsiderueshëm juristësh mendojnë se për ta cilësuar krimin si gjenocid, atëherë, një numër më i madh personash duhet të jenë goditur nga ky veprim. "Disa flasin për qindra persona të vrarë e të tjerë për mijëra viktima, si kusht që të kualifikohet krimi si gjenocid". (Thomas Benages, La Convention pour la prévention et la répression du crime de génocide à l'épreuve du tribunal pénal international pour l'ex-Yougoslavie, f. 143). Fatkeqësisht kur bëhet fjalë për gjenocidin e Serbisë në Kosovë, në diskursin publik bëhet një ndërlidhje ndërmjet termit "zhdukje" dhe gjenocidit. Kjo qasje është shumë e gabueshme, sepse lë të nënkuptohet se gjoja gjenocidi nuk është kryer në Kosovë, meqenëse nuk na paskan "zhdukur"! Dhe në përputhje me këtë logjikë, jo rrallë përdoret edhe shprehja "tentim për gjenocid", që ndërthen në vete, në një masë të konsiderueshme, shfaqësimin e Serbisë, për gjenocidin e kryer. Kur kemi të bëjmë me përmasat e vrasjeve në kuadër të krimin të gjenocidit, një gabim i madh bëhet kur krahasohet numri i të vrarëve në Kosovë

me numrin e të vrarëve në gjenocidin nazist kundër hebrenjve apo atij të Hutuve kundër grupit etnik Tuci në Ruandë.

Përmasat e vrasjeve të hebrenjve dhe të Tucive paraqesin raste ekstreme të gjenocidit dhe nuk mund të merren si kritere për ta kualifikuar një krim si krim të gjenocidit.

Manipulimi me statistika, ku njerëzit shtohen dhe zbriten në operacione matematike me qëllim që të banalizohet "shtimi i krimeve" dhe "zbritja e jetëve të njerëzve të pafajshëm" është neveritëse. Cilësimi i krimeve në Kosovë si gjenocid nuk ka për qëllim t'i banalizojë gjenocidet e aplikuar kundër popujve tjerë në periudha të ndryshme kohore. Përkundrazi, manipulimi me numrin e vrasjeve dhe heshtja e qëllimit për të shkatërruar shqiptarët e Kosovës, paraqet një formë të banalizimit të krimeve me qëllim të mohimit të këtij gjenocidit.

Sipas Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimin të Gjenocidit dhe Statutit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare, nuk duhet "të

zhduket" një grup kombëtar, etnik, racor ose fetar apo të ketë miliona të vrarë për ta cilësuar krimin si gjenocid. Duhet të dëshmohej qëllimi se aktet e dhunës janë në funksion të shkatërrimit të tërësishtëm ose të pjesëshëm të grupeve të mbrojtura me konventën e lartpërmendur. Nga cilido këndvështrim juridik që të trajtohet numri i të vrarëve gjatë luftës në Kosovë, vrasjet e 1392 fëmijëve shqiptarë, vrasjet e 1739 grave shqiptare, vrasjet e mbi 10.000 civilëve të tjerë shqiptarë të të gjitha moshave dëshmojnë se forcat serbe aplikuan gjenocidin në Kosovë, sepse kishin për qëllim shkatërrimin e tërësishtëm ose të pjesëshëm të shqiptarëve të Kosovës si grup kombëtar, etnik apo fetar i ndryshëm nga serbët. Kur t'i marrim parasysh të gjitha kriteret e përkufizimit të gjenocidit dhe kur numrit të shqiptarëve të vrarë ia shtojmë numrin e të plagosurve, të zhdukurve, të dhunuarave seksualisht, të dëbuarve me dhunë gjatë politikës së spastrimit etnik dhe aktet e tjera që cilësohen si akte të gjenocidit, atëherë do të dalin në dritë përmasat jashtëzakonisht të mëdha të gjenocidit të Serbisë në Kosovë.

Bisedime po, por kompromis të ri jo!



Jakup KRASNIQI

Një përgjigje të gjithë atyre që kërkojnë kompromis të ri nga Kosova në dialogun me Serbinë. Kosova e ka bërë kompromisin e madh në bisedimet e Vjenës. Ata që nuk besojnë, le të kërkojnë sqarime nga drejtuesit kryesorë të atyre bisedimeve.

1. Në Kosovë kemi bërë bisedime politike dhe kompromisin e madh në bisedimet e Vjenës gjatë viteve 2006 - 2007 në praninë dhe nën mbikëqyrjen e BE-së dhe të Grupit të Kontaktit. Bisedimet

janë udhëhequr nga emisari special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.

2. Bisedimet politike të Brukselit (BE-së) padrejtësisht e kanë hapur çështjen e statusit politik të shtetit të pavarur, sovran e demokratik të Kosovës të shpallur në koordinim me Komunitetin Ndërkombëtar, e sidomos me vendet e Grupit të Kontaktit, pas bisedimeve të Vjenës.

3. Me shpalljen e Pavarësisë më 17 shkurt 2008 dhe pas përgjegjës se GjND-së në pyetjen e Serbisë, se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk bie ndesh me ligjin ndërkombëtar, bisedimet politike me Beogradin kanë qenë të përfunduara. Këtë e ka konfirmuar edhe Asambleja e Përgjithshme e OKB-së e cila, pas vendimit të GjND-së me

Rezolutë, ka kërkuar nga Kosova e Serbia që të zhvillojnë bisedime teknike për përmirësimin e jetës së qytetarëve të dy vendeve nën mbikëqyrjen e Brukselit.

4. Kosova është për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë në kufijtë ekzistues të njohur edhe ndërkombëtarisht. Serbia po kërkon e kërcënon me agresion të ri mbi Kosovën. Këtë po e kërkojnë zyrtarët më të lartë të saj.

5. Qeveria serbe duhet të obligohet që të distancohet nga politikat e krimin të gjenocidit, gjë të cilën ajo nuk e ka bërë, përkundrazi ajo i mohon ato.

6. Nuk duket që kjo klasë politike që qeverisë në Beograd është e gatshme që t'i normalizojë marrëdhëniet me Kosovën e shqiptarët.

7. Në gjithashtu jemi të bindur se

as pala jonë e as evropianet nuk e kanë gjetur gjuhën që e kuptojnë zyrtarët e lartë në Beograd, të cilët janë trashëgimtarë të politikës së Serbisë së Millosheviqit. Millosheviqi ka kryer krime të gjenocidit në Kosovë, pasardhësit e tij sot i mohojnë paturpësisht ato politika gjenocidiale.

8. Beogradi zyrtar është duke i penguar shumë qytetarët serbë të Kosovës që të integrohen në jetën politike e publike në Republikën e Kosovës. Integrimi i serbëve të Kosovës në jetën politike e publike është penguar nga bisedimet politike të Brukselit.

9. Para bisedimeve politike të Brukselit ka pasur një integrim të dukshëm të serbëve të Kosovës në jetën politike e publike në Kosovë. Lista Serbe si pjellë e bisedimeve të Brukselit nuk është për integrimin e serbëve në

shtetin e Kosovës, është për copëtimin e Kosovës dhe, si e tillë është, antikushitetuese (e jashtëligjshme).

10. Gjithashtu, ne jemi më shumë se të bindur se Kosova ka bërë shumë kompromise në bisedimet e Vjenës dhe nuk bën të bëjë kompromis të ri. Çdo kompromis i ri e bën jofunksional shtetin.

Bisedimet politike në mes të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel, me mbikëqyrjen e BE-së, për më shumë se gjashtë vjet s'ishin gjë tjetër vetëm një labirint pa shtegdalje. Edhe nëse do të krijonte dalje, dalja do të ishte një pus i pafund. Vazhdimi i këtij labirinti nuk krijon normalizim të marrëdhënieve e as dalje paqësore, pasi të gjitha palët në këtë dialog ishin sa joserioze, aq edhe të papërgjegjshëm.

Deçani nderon dëshmorin Brahim Demalilaj

DEÇAN, 5 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe familjarë, kanë përkujtuar dëshmorin Brahim Demalilaj. Me këtë rast ata kanë bërë homazhe në kompleksin e dëshmorëve në fshatin Strellc i Epërm, ku pushon trupi i pajetë

i dëshmorit Demalilaj. "Me homazhe dhe vendosje të kurorave me lule aty ku pushon përjetësisht dëshmori i kombit, Brahim Demalilaj, në kompleksin e dëshmorëve në fshatin Strellc i Epërm, sot në përvjetorin e rënies është përkujtuar nga i pari i komunës, Bashkim Ramosaj, nënkryetari

Sami Cacaj, kolonel Abdyl Mushkolaj, deputetë, zyrtarë komunalë, përfaqësues të klerit fetar, familjarë dhe qytetarë. Është obligimi ynë ta ruajmë shenjtërinë e gjakut të derdhur duke mos lejuar të harrohet asnjëherë", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Deçanit.



Në hotelet e Kosovës për tre muaj qëndruan 65 mijë vizitorë

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat e hotelerisë në Kosovë për tremujorin e parë të këtij viti. Në tremujorin e parë të vitit 2019 pjesë e anketës ishin 218 hotele që ushtrojnë veprimtari hoteliere në territorin e Kosovës. Në këtë tremujor numri i vizitorëve (vëndorë dhe të huaj) ishte 65 265, prej tyre 41.85 për qind janë vëndorë dhe 58.15 për qind janë të huaj, ndërsa numri i netqëndrimeve ishte 104 907, prej tyre 39.70 për qind nga vëndorët dhe 60.30 për qind nga të huajt



EPOKA E RE | **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Në tremujorin e parë të vitit 2019 numri i vizitorëve në hotelet e Kosovës ishte 65.265, prej tyre 58.15 për qind ishin të huaj. Kështu thuhet në raportin "Statistikat e hotelerisë, tremujori i parë 2019", të publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Sipas ASK-së, numri i netqëndrimeve në këtë tremujor ishte 104 907 bujtje. "Në tremujorin e parë të vitit 2019 pjesë e anketës ishin 218 hotele që ushtrojnë veprimtari hoteliere në territorin e Kosovës. Pjesa më e madhe e hoteleve gjenden në rajonin e Prishtinës, Pejës, e kështu me radhë. Në këtë tremujor numri i vizitorëve (vëndorë dhe të huaj) ishte 65 265, prej tyre 41.85 për qind janë vëndorë dhe 58.15 për qind janë të huaj, ndërsa numri i netqëndrimeve ishte 104 907, prej tyre 39.70 për qind nga vëndorët dhe 60.30 për qind nga të huajt", thuhet në raportin e ASK-së.

Sa i përket numrit të vizitorëve, rajoni i Prishtinës është në vënd të parë, pasuar nga ai i Prizrenit. "Numrin më të madh të vizitorëve dhe netqëndrimeve të tyre

e ka rajoni i Prishtinës me 28 876 vizitorë me 48 561 netqëndrime. Numri më i madh i vizitorëve të huaj përqendrohet në Prishtinë dhe Prizren. Sa iu përket vizitorëve të huaj, numri më i madh i tyre ishte nga Shqipëria, Turqia, Gjermania etj", është theksuar në raport.

Çmimet e importit u ngritën 3.5 për qind

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) po ashtu ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Importit (IÇIMP) për tremujorin e parë (TM1) të vitit 2019. Indeksi i tërësishtëm i çmimeve të importit në Kosovë pësoi rënie për (-0.4 për qind) në TM1 2019, krahasuar me TM4 2018. "Rënie më të mëdha të çmimeve sipas sektorëve ishin te: pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (-6.1 për qind); tekstili dhe artikujt prej tij (-2.7 për qind); letra dhe artikujt prej saj (-0.8 për qind); vajrat ushqyese (-0.5 për qind); lëkura dhe artikujt prej saj (-0.5 për qind); mjetet e transportit (-0.4 për qind); shtazët e gjalla dhe prodhimet e shtazëve (-0.4 për

qind); metalet bazë dhe artikujt prej tyre (-0.3 për qind); dhe plastika, kauçuku dhe artikujt prej tyre (-0.2 për qind)", është thënë në raportin e ASK-së, duke u shtuar se rënia u neutralizua kryesisht nga ngritja e çmimeve sipas sektorëve te: prodhimet bimore (3.3 për qind); prodhimet minerale (2.3 për qind); këpucët (1.5 për qind); artikujt e ndryshëm të prodhuar (0.7 për qind); druri dhe artikujt prej tij (0.4 për qind); artikujt ushqimorë të përgatitur, pijet dhe duhani (0.2 për qind); prodhimet e industrive kimike (0.1 për qind); dhe instrumentet optike, fotografike, matëse, mjekësore dhe muzikore, si dhe mekaniz-

mat e orës (0.1 për qind). Sipas ASK-së, krahasuar TM1 2019 me TM1 2018, çmimet e importit u ngritën në një mesatare prej 3.5 për qindësh. "Ngritjet më të mëdha sipas sektorëve ishin te: prodhimet minerale (21.7 për qind); lëkura dhe artikujt prej saj (19.9 për qind); shtazët e gjalla dhe prodhimet e shtazëve (9.3 për qind); instrumentet optike, fotografike, matëse, mjekësore dhe muzikore, si dhe mekanizmat e orës (7.9 për qind); këpucët (5.0 për qind); druri dhe artikujt prej tij (4.8 për qind); plastika, kauçuku dhe artikujt prej tyre (4.2 për qind); artikujt e ndryshëm të prodhuar (3.5 për qind); prodhimet e industrive

kimike (2.8 për qind); artikujt e gurit, llaçit, prodhimet e qeramikës dhe të qelqit (2.1 për qind); letrat dhe artikujt prej saj (1.6 për qind); mjetet e transportit (1.3 për qind); dhe artikujt ushqimorë të përgatitur, pijet dhe duhani (0.6 për qind)", thuhet në raportin e ASK-së. Gjithnjë sipas këtij raporti, ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve te: tekstili dhe artikujt prej tij (-11.5 për qind); pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (-3.0 për qind); vajrat ushqyese (-2.7 për qind); metalet bazë dhe artikujt prej tyre (-1.6 për qind); dhe prodhimet bimore (-0.6 për qind).

Aeroporti shënon Ditën e Mjedisit me moton 'Plastic Free Airport'



PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Dita Botërore e Mjedisit 2019 në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" është shënuar me aktivitete që kontribuojnë në parandalimin e ndotjes nga përdorimi i plastikës. Si hap të parë, ANP "Adem Jashari" ka marrë përsipër zëvendësimin e gotave të plastikës me gota porcelani të personalizuar për secilin

punëtor me emrat e tyre. "Është e rëndësishme të kemi sa më shumë njohuri rreth ndotjes nga përdorimi i plastikës, si një nga kërcënimet më të mëdha për mjedisin tonë. Për një aeroport pa produkte plastike, ne do të fillojmë duke eliminuar produktet plastike për një përdorim", ka thënë me këtë rast drejtori gjeneral i ANP "Adem Jashari", Haldun Firat Kokturk.

Iniciativa "Aeroport pa produkte plastike" mund të jetë lëvizje e madhe për mbrojtje të mjedisit dhe jetë të shëndetshme. ANP "Adem Jashari" vazhdimisht është duke punuar edhe në zvogëlimin e nivelit të dyoksidit të karbonit si dhe në menaxhimin e trajtimit të ujit në mënyrë që të kontribuojë për një ambient të gjelbër dhe të pastër.


Malisheva ka bërë përgatitjet për shënimin e Ditës së Çlirimit

MALISHEVË, 5 QERSHOR (ER) - Në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve e cila është drejtuar nga nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, është bërë me dije se merastin e shënimit të 16 qershorit, Ditës së Dëshmorëve dhe Ditës së Çlirimit të Malishevës, do të zhvillohen aktivitete të shumta, kulturore dhe

sportive, krahas aktiviteteve të tjera të rregullta dhe zyrtare. Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Besartë Kryeziu-Ramaj, ka theksuar se janë duke u bërë përgatitjet e duhura për shënimin e 16 qershorit, që këtë vit është dhe jubilar, pasi është 20-vjetori i çlirimit të Malishevës. "Aktivitetet janë të shumta ku, kra-

has aktiviteteve zyrtare, si mbledhjet solemne, nderimet dhe homazhet dhe tubimi qendror, gjatë tërë javës do të ketë aktivitete të shumta kulturore dhe sportive të cilat janë përgatitur për këtë rast", ka thënë Kryeziu-Ramaj. Në këtë mbledhje drejtorët e drejtorive komunale kanë raportuar para nënkryetarit Berisha për


punët dhe aktivitetet e tyre gjatë javës së kaluar dhe për planifikimet për këtë javë. Bazuar në këto raportime, në ditët e ardhshme do të fillojnë të realizohen edhe shumë projekte të planifikuara, pjesë e investimeve kapitale që kryesisht lidhen me infrastrukturën. Po në këtë mbledhje është bërë me dije se nga java e ardhshme, varësisht



prej kushteve atmosferike, pritet të fillojë edhe fushata e dezinfektimit kundër rriqrave në zonat endemike.

Vështrim special për profesor Ukshin Hotin

Ukshin Hoti në luftë që një popull i ndarë të rreshtohet në rrugën e përparimit dhe bashkimit



Prof. dr. Hakif
BAJRAMI


Të shkruash dhe të gjykoj drejt për profesor Ukshin Hotin nuk mundet askush të japë ndonjë vlerësim objektiv pa u analizuar çdo gjë që ka shkruar, çdo dokument që ka mbetur në arkiva, sepse për një kohë të gjatë e ka drejtuar dikasterin e punëve të jashtme të Kosovës. Pastaj ka bërë punë arsimore-shkencore, ka bërë burg, ka drejtuar revista të mendimit politik dhe ka qenë drejtues i një partie politike. Lidhur me këtë, profesori, politikani dhe diplomati Ukshin Hoti në shkrimet e tij të para i nxjerr në shesh të gjitha komplotet antishqiptare nëpër simpoziume jo vetëm jugosllave, por edhe evropiane që nga viti 1976. Në këtë rreshtim prof. Ukshini ngritët fuqishëm kundër padrejtësive dhe servilizmit, çyçarisë, apatisë dhe, më së tepërmi, kundër urrejtjes. E ngjeshur kështu, filozofia politike e Ukshin Hotit nuk mbetet e plasuar në premisat e kabineteve akademike, nuk mbetet politikë e estradave dhe profkave patetike, e poltronëve dhe super-poltronëve, por është dhe premtori të mbetet metaforë e ndërgjegjes dhe moralit të një populli, liria e të cilit ka korniza dhe çmim, që lufton për t'u çliruar nga prangat e burgut, për t'i ngjeshur pastaj armët, që ato pranga t'i bëjë copë e grimë. Prandaj, nuk është e rastësishme klithma e tij kushtrimore kur thotë: "Bëje ose vdis". Kjo do të thotë se profesor Ukshini u drejtohet shqiptarëve: "E bëni republikën e Kosovës të pavarur ose dilni në fushën e

mejdanit për me vdekë për liri". Në filozofinë sociale dhe politike të Ukshin Hotit të gjithë qytetarët duhet t'i shquaj vendosmëria ku ata kanë mundësi: të mendojnë, të flasin dhe të veprojnë të lirë. Në filozofinë diplomatike Ukshini gjurmon, në filozofinë ekonomike akuzon, ndërsa në filozofinë e historisë shpërthen si vullkani, dhe i akuzon të gjithë okupatorët, pa dallim. E kundërta në shkrimet e prof. Ukshinit politika e okupatorit mbetet konstante sepse ajo nuk guxon të ndryshojë nga frika se prangat i rrëshqasin nga dora, prandaj aty mësohet se qytetari i rendit të dytë nuk ka nevojë të mendojë e të flas, por duhet të veprojë ashtu si i ka ligjet dhe normat robëruesi. E pra, Ukshin Hoti është në luftë jetësore për zhveshjen e kësaj shoqërie të këtyre kastave, klaneve, koropacioneve dhe rogozëve të tyre, dhe tërë këtë, sipas tij mund ta shporrë çdo popull nëse nuk i frikësohet çmimit të lirisë dhe sakrificës për të, sepse liria universale duhet të shndërrohet në vlerë të shtuar globale. Lidhur me këtë, duke e lexuar shumicën e studimeve të Hotit, kuptohet se globalizmi nuk arrihet pa mençuri-arsimim, pa forcimin horizontal të gjigantëve ekonomik, por që gjithmonë duhet pasur në mendje që koncernet e globalizmit ndrydhin sërish të varfrit dhe të robëruarit, që në të njëjtën kohë, kombi duhet ta shporrë frikën dhe inferioritetin, dhe mu këtu shqiptarët duhet të sfidohen se çdo gjë që i rrezikon në Ballkan, nuk mundet ma të konsiderohen se kjo Siujdhesë ishte dhe mbetet një "fuqi baruti" për paqen, sepse këtu plaga shqiptare ende kullon padrejtësi, prandaj shqiptarizmit i duhen miq për t'u çliruar nga e kaluara shekullore në robëri. Prandaj, në emër të "atësisë" shqiptarët nuk duhet ta shtrijnë ma qafen dhe të pajto-

hen me çdo gjë që vjen nga lartë poshtë, pozitë kjo që ia imponuan gjashtë fuqitë evropiane nëpër kongrese e konferenca "paqësore". Këtë rreshtim Ukshin Hoti nuk është i gatshëm ta pranojë kurrë, me asnjë çmim, sepse e kishte para syve shembullin e Adem Demaçit, i cili kurrë nuk iu përkul inferioritetit, para askujt. Me këtë rreshtim Ukshin Hoti, nuk është mësim i urtë vetëm për popullin e tij, por nga kjo rrugë nxjerrë konkluzën se politikën dhe ekonominë sidomos

injanca, dhe mu për këtë, kemi kaq liri sa që askush nuk po pyet: Pse kemi "tepër liri" diku-diku, edhe na ka përfshirë anarkia, korrupsioni dhe voluntarizmi se: "problemet tona lokale" kurrë nuk do na i zgjidhin burrat dhe administratorët e Gjermanisë dhe Amerikës, ndërsa ne vrapojmë që për një gjysmë dekadë të avancohemi në kapitalist "modern", të tipit aristokratik. Në publikimet e botuara dhe të pabotuara të prof. Ukshin Hotit, mësohet se shqiptarët me kohë kërkuar një shtet modern

mobilitet mashtuesish dhe bajraktarësh. Duke u forcuar me urti shqiptarët sipas Ukshin Hotit nuk duhet të pranojnë pozitë inferiore për kombin e vet. Së këndejmi, tragjedinë e individit, të grupit dhe të etnisë popullore, Ukshin nuk e përplasë me ngjyra të "jelekave dhe jataganave" të fiseve, por nxjerr nga populli si ndërgjegje horizontale që e ka përfshirë çdo pore të jetës së tij, që ka peshë ingenioze mbi të gjitha, që ka kualitet jetësor, që ka sinqertë dhe edukate të sojit të besës, e cila i ka përjetuar shekujt me parmin e saj etik dhe human. Ja, këtë koncept e projektton Ukshin Hoti jo vetëm për kombin e vet. Mu për këtë arsye prof. Ukshin Hoti mbetet filozof i perspektivës dhe diplomat i grafisë politike evropiane, sidomos në kthesat e mëdha. E nëse inteligjencia dhe populli shqiptar nuk e mëson këtë filozofi, vonesën si trashëgim e ka të sigurt. Me këtë prof. Ukshin nuk pajtohet kurrë se shqiptarizmi do të pajtohet me status quo. Jo shqiptari i Ukshin Hotit, njeriu i rëndomtë tek e fundit pa dallim përkatësi, race e religjioni, kulture dhe niveli të pasurisë, është dhe mbetet, "gymtyrë dinamike, dynamikinë e trurit dhe diturisë, që do të shpërndajë edhe tek të tjerët: urti e dituri, besë-kulturë, sepse mjaftë ka marrë shekuj robërie në pronësi. Pra, ka ardhur koha që shqiptaria të japi atë që mundet, së pari ta çlirojë Kosovën tërësisht nga patkonjtë e mirrobergjesisë violente, nga robëria sllave, që sot destabilizon dhe nesër nëse vazhdon do të vejë në pyetje edhe strukturën e çlirimit jo vetëm në Ballkan, e në vijim copa-copa shqiptarizmi duhet t'i bashkojë zogjtë e shqipës në një fole, nën Flamurin e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut". Ky ishte dhe mbetet testamenti filozofik i prof. Ukshinit. Lavdi!



në Evropë e ka mbajtur gjallë dhe shumë herë të bashkuar vetëm pasuria, sepse askush nuk do pajtim të njëanshëm në varfëri, e pasurinë që e kanë grumbulluar okupatorët nuk shporret pa fuqinë e armës. Askush, mësonte Ukshin Hoti nuk ta falë larinë dhe pavarësinë në tavolinë. Ukshin Hoti me shkrimet e tij edhe sot mbetet politikani më pragmatik, sepse në fund të shekullit kaluar e pati shtruar qëndrimin parimor jetësor a do të hyjmë në shekullin XXI si të eksplotuar dhe të kemi nevojë për tutor që të klithim para tyre: "na ndihmoni", për t'u bërë pastaj shërbyes të tyre. Ç'është e vërteta, shqiptarët sot janë popull politik, por në asnjë instancë nuk janë të kursyer nga

evropian, një parlament ligjdhenës, një shkollë kombëtare evropiane, një kryeqytet (Manastirin), një shtypshkronjë dhe një informatikë të lirë dhe të pavarur nga robëria e klaneve dhe trofeve shtetërore. Madje Ukshini i drejtohet partive politike që ndajnë dhe furnizojnë dhunë padrejtësish në emër të emancipimit demokratik, e që një orë e më pare të rreshtohen në filozofinë demokratike në emetues dhe humanizim të jetës jetuar. Shqiptarët në të gjitha shkrimet e tij Ukshin Hoti, i fton të integrohen rreth një flamuri, një gjuhe, me një filozofi politike që i gëzon miqtë, i tmerron armiqtë në të njëjtën kohë. Kjo filozofi i fton shqiptarët në aksion, por jo në

Shkolla 'Hasan Prishtina' në Shtime feston 74-vjetorin e themelimit

SHTIME, 5 QERSHOR (ER) - Shkolla Filllore dhe e Mesme e Ulët "Hasan Prishtina" në fshatin Godanc të Shtimes ka festuar 74-vjetorin e themelimit. Për historikun dhe të arriturat e kësaj shkolle ka folur drejtoresha Zade Mustafa. Të pranishmit në këtë përvjetor të themelimit i ka përshëndetur drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Mensur Neziri, i cili ka përgëzuar nxënësit dhe mësimitdhënësit duke iu uruar suksese në angazhimet e tyre. Me këtë rast, në emër të Shoqatës së Veteranëve të Arsimit të Shtimes, Banush Imeri, ka uruar mësimitdhënësit dhe nxënësit për



ditën e shkollës dhe sukseset e treguara brenda një viti shkollor. Për këtë ditë festive të shkollës nxënësit kishin përgatitur një program kulturor-artistik që është mirëpritur nga të gjithë.

Komuna e Junikut mban dëgjim publik për buxhetin e vitit 2020

JUNIK, 5 QERSHOR (ER) - Komuna e Junikut, e cila drejtohet nga kryetari Agron Kuçi, të premtën do të mbajë dëgjim publik me qytetarë në lidhje me buxhetin e kësaj komune për vitin 2020. Kjo komunë ka ftuar junikasit që të bëhen pjesë e këtij dëgjimi publik në mënyrë që t'i trajtojnë kërkesat e tyre gjatë hartimit të buxhetit komunal. "Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Junikut se më 7. 6. 2019, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit Komunal mbahet dëgjimi i parë publik për buxhetin e vitit 2020. Me pjesëmarrjen, kontributin dhe sugjerimet tuaja



ju jeni pjesë e planifikimit buxhetor dhe shqyrtimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) për vitet 2020-2022", ka njoftuar Komuna e Junikut.

Sot promovohet libri 'Dëshmitar në kohë historike' i Rexhep Qosjes

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Sot (e enjte) promovohet libri më i ri i akademik Rexhep Qosjes "Dëshmitar në kohë historike, Ditari VIII, Koha e protektoratit (1999-2001)". Promovimi i librit bëhet në Institutin Albanologjik në Prishtinë në orën 12:00.

Akademik Rexhep Qosja përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka publikuar disa shkëputje të këtij libri.

Disa shkëputje nga ditari:

10.7.2000

Në diskutimin e tij Hashim Thaçi thotë se vetëm Ibrahim Rugova e mbështet Marrëveshjen e mirëkuptimit Kushner-Artemije, që e kthen Kosovën shumë mbrapa! Mjerisht kjo Marrëveshje ndoshta miratohet nesër në Këshillin e Përkohshëm Administrativ!

Të gjithë diskutuesit e kundërshtuan atë Marrëveshje.

Si më tutje? Sipas këtij mospajtimi me atë Marrëveshje?

- Mbledhja e sotme, - thotë Hashimi, - është vetëm konsultuese. Domethënë: për si më tutje as Hashimi vetë e as Partia që kryeson nuk paskan menduar!

Në diskutimin tim të shkurtër thash:

- Pse kjo mbledhje është vetëm konsultuese? Në këtë mbledhje do të duhej të krijohet qëndrim i përbashkët për shumë çështje për të cilat nuk i kemi njësuar qëndrimet. Dhe, ky qëndrim i

përbashkët do të duhej të krijohet në konsultime me udhëheqjet e partive para se të mbahej kjo mbledhje. Kolegët e PDK-së dua t'i pyes: a e keni ngrirë pjesëmarrjen në të gjitha nivelet e strukturave të përbashkëta?

23.11.2000

Sot afër shtëpisë së tij është vrarë gazetari e publicisti i njohur, zëdhënësi i LDK-së, Xhemajl Mustafa.

Ky lajm i zi më tronditi shumë. Xhemajl Mustafa ishte njeri i qetë, i urtë, nuk bënte keq, nuk fliste keq, shkruante për veprat letrare e shkencore të atyre me të cilët pajtohej dhe të atyre me të cilët mund të mos pajtohej politikisht. Ai kishte shkruar fare mirëkuptueshëm edhe për ndonjë vepër timen.

Kush mund ta ketë vrarë? Kush? Nuk vriten krijuesit! Nuk vriten gazetarët!

Ç'është kjo dhunë shkatërruese, që po na rrezikon si popull! Edhe stacione të huaja televizive e japin lajmin për vrasjen e Xhemajl Mustafës, për këtë vrasje më zi se kriminale! E dënoj me mendje e me shpirt këtë vrasje skajshëm tragjike.

14.6.2000

Me vonesë, diku rreth mesditës, marr vesh se Bernard Kushneri ia ka ndaluar hyrjen në Kosovë kryetarit të Partisë Demokratike të Shqipërisë, Sali Berisha. Mbrëmë ia kishte çuar atij një

letër në Kukës, ku ai kishte mbërritur me shumë partizanë të tij, me të cilën e kishte njoftuar se nuk i lejohet hyrja në Kosovë. I pezmatuar, i pezmatuar dhe i fyer për shkak të kësaj ndalese, Sali Berisha, në stilin e tij bolshevik, do të deklarojë po në Kukës se:

- I gjallë ose i vdekur do të hyj në Kosovë!

Për fatin e tij dhe të familjes së tij, Sali Berisha menjëherë ishte nisur shëndosh e mirë për në Tiranë.

21.3.2000

- Jam shumë i befasuar, kolegë të nderuar, që institucionet e arsimit e të shkencës janë përjashtuar prej Buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Ne kemi një Departament, që quhet Departamenti i Arsimit e i Shkencës, dhe ky Departament, siç e thotë edhe emri, përbëhet prej dy përbërësve institucionalë - prej arsimit dhe prej shkencës. Si është e mundshme, prandaj, që ky Departament të mos ketë trajtim të njëjtë në Buxhetin e Kosovës me departamentet e tjera, por një pjesë e përmbajtjes së tij, e quajtur shkencë, të përjashtohet prej Buxhetit! Unë nuk jam në gjendje ta kuptoj, dhe nuk jam në gjendje ta kuptoj sepse nuk ia gjej arsyet qëndrim-it të tillë shpërfillës ndaj institucioneve tona shkencore! Pse ndodh kjo? Pse ndodh kështu? Cilat janë arsyet e kësaj shpërfilljeje?

Këto institucione shkencore, të quajtura Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Instituti Albanologjik i Kosovës, Instituti i Historisë i Kosovës, janë institucione shkencore të themeluara prej Kuvendit të Kosovës, kurse tani i bën të paqena dikush që unë nuk po e di se kush është ai! As Këshilli i Përkohshëm Administrativ, as Departamenti i Arsimit dhe i Shkencës nuk i ka hequr prej regjistrit të rrogave as prej Buxhetit të Kosovës.

Kush i ka hequr?

Unë, si anëtar i këtij Këshilli, nuk kam mandat për mbylljen e



institucioneve të lartpërmendura shkencore të Kosovës dhe këtë mandat edhe po të donte të ma jepte dikush unë kurrë nuk do ta pranoja.

Unë nuk pajtohem me qëndrimin e paraqitur këtu ndaj këtyre institucioneve.

Unë, jo vetëm nuk pajtohem, por edhe protestoj ndaj këtij qëndrimi.

15.3.2001

KTV-ja ka zhvilluar bisedë (intervistë) me Arbën Xhaferin. Gazetari, me pyetjet që i bën, i jep mundësi të nxirret nga lloçi në të cilin është zhytur në paraqitjet e mëparshme. Nxirret deri diku, vetëm deri te molla e gushës, kurse prej gushës e më lart - me sytë e me gojën mbetet në lloç! I dënon edhe më tej luftëtarë, por thotë se në Maqedoni ka probleme të pazgjidhura. Ka probleme të pazgjidhura, thotë Arbeni, kurse vetë merr pjesë në pushtetin që nuk i zgjidh ato probleme dhe dënon ata që kërkojnë vetëflijueshëm zgjidhjen e tyre! Kuku, Arbën, çka po bën!

18.8.2000

Ylli, Luani dhe Eduardi më flasin edhe për Historinë e Shqipërisë, që po punohet në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Ende nuk e kanë vendosur se si do të quhet: Histori e Shqipërisë apo Histori e popullit shqiptar. I kanë ftuar disa historianë dhe disa anëtarë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të

Kosovës, që të diskutojnë rreth kësaj historie dhe u kanë propozuar që, mundësisht, të botohet si vepër e dy akademive. Ata të Prishtinës, thanë, e kanë propozuar Zekeria Canën si përfaqësues të historianëve të Kosovës në bisedën rreth kësaj çështjeje. Dhe, më tej, ata të Prishtinës kanë kërkuar që në këtë bisedë dhe në punën rreth historisë në fjalë Prishtina të jetë e përfaqësuar me aq autorë sa edhe Tirana! Por, teksti është pothuaj gati dhe nuk ka sesi të futen si autorë emra që s'kanë bërë punë! Dhe, më tej, thanë se janë posaçërisht shumë të befapsuar nga sjellja agresive e njëfarë Hivzi Islamit. Gjatë bisedës, në një çast, ai farë Hivzi u ka thënë, i nevrikosur, tepër i nevrikosur, ndoshta i çekuilibruar:

- Kosova ua ka thyer hundën dy perandorive - otomane e serbe dhe do t'ia thyejë edhe Shqipërisë!

Kjo i ka lënë pa tekst akademikët dhe historianët e Shqipërisë, që po merrnin pjesë në bisedën me kolegët e tyre nga Kosova për tekstin e Historisë në fjalë. Por, pas disa çastesh, mbasi e kishte marrë veten, akademik Luan Omari i ishte drejtuar me këto fjalë atij:

- A e di ti se çka po flet?! Heshtje e gjatë.

Rexhep Qosja, "Dëshmitar në kohë historike, Ditari VIII, Koha e protektoratit (1999-2001)".



Hapet Panairi i Librit

PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Të mërkurën është hapur Panairi i Librit "Prishtina 2019", edicioni i 21-të, i cili do të mbahet deri më 9 qershor në ambientet e Pallatit të Rinisë, organizuar nga Shoqata e Botuesve të Kosovës. Në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës, Panairi i Librit është pjesë e 20 aktiviteteve kulturore, sportive

dhe inovative për përkujtimin e 20-vjetorit të çlirimit të qytetit të Prishtinës.

Panairi do të qëndrojë i hapur për vizitorë çdo ditë nga ora 09:00 deri në orën 20:00. Në këtë panair marrin pjesë rreth 100 botues nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe diaspora, ndërsa numri i titujve të rinj vlerësohet të jetë

mbi 1 500, ndërsa numri i titujve në vitet e fundit është rreth 5 500.

Panairin pritet ta vizitojnë rreth 40 mijë vizitorë, kryesisht studentë, nxënës të shkollave të mesme dhe fillore të Kosovës, qytetarë dhe personalitete të shquara nga jeta akademike, letrare, politike dhe intelektuale e Kosovës.

E jashtëzakonshme

Mysafiri i paftuar në kuzhinë

Një pronare është befasuar nga një mysafir i paftuar që ishte futur në kuzhinën e saj. Gruaja 77-vjeçare nga Florida u zgjua në mëngjes për të gjetur një aligator 3.3 metra në kuzhinë. Mary Wischhusen u ngre rreth orës 03:30 pasi dëgjoi një zhurmë të madhe në banesë. Kur shkoi për të parë se çfarë po ndodhte u përball me zvarranikun e madh.



FOTO E DITES



Peshkatarët shihen duke tërhequr një barkë në bregun e detit arab në Indi. /AP/

E rrallë

Një gur smeraldi zbulohet në Rusi

Një smerald me peshë 1.6 kilogram është gjetur në Rusi. Guri i çmuar është më i madhi i zbuluar në 30 vjet. Guri mendohet se ka një vlerë deri në 500 000 dollarë. Kristali i rrallë, që ka një madhësi dhe formë unike, u gjet në një thellësi 260 metra në Malyshevsky.



BARSOLETA E DITËS



Bujku: Nuk po me ec puna mirë.
Magjistari: Mbaje një patkua, se të sjellë fat.
Bujku: Kali im i ka katër patkonj, por gjithë ditën hanë dajak!




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

“DUMBO” 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
Regjia: Tim Burton



Ne ora 16:00 dhe 19:00
“AVENGERS; Endgame”

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

“EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE”

Krim/Mister; 1 ore 48 min

Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
Regjia: Joe Berlinger



16.05.2019

“THE HUSTLE”

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Humori ditën e sotme nuk është në nivele të kënaqshme. Megjithatë, partneri do të përpiqet t'ju tregojë se është pranë.



DEMI

Keni vullnet dhe do të bëni shumë përpara në një projekt të rëndësishëm. Me dëshirën e mirë për të ndihmuar sot do të jeni pranë dikujt.



BINJAKËT

Sot do të ketë pak tension në jetën në çift, por kjo gjë nuk do të ndikojë në ndjenjat që keni për njëri-tjetrin.



GAFORRJA

Të gjithë do të kenë nevojë për ndihmën tuaj sot. Vendosi mëria që ju karakterizon ju bën shumë të veçantë.



LUANI

Sot bëni mirë të mos flisni me këdo lidhur me një çështje delikate tuajën. Shumë fjale do të keqpërdoren në të ardhmen.



VI RGJËR ESHA

Megjithëse për momentin financat tuaja nuk janë aq mirë sa ju mendoni, do të keni shpenzime që kanë lidhje me shtëpinë dhe familjen.



PESHORJA

Sot jeni të dashuruar me natyrën, me qetësinë dhe me çdo gjë të bukur. Një piknik me njerëzit e afërt është ideali për ju.



AKREPI

Çështjet e xhelozisë do ta prish disi marrëdhënien në çift. Bëni mirë të tërhiqeni nga xhelozia.



SHIGJETARI

Dita e sotme është një ditë shumë e bukur për ju. Çdo gjë është në harmoni dhe ju ndiheni mjaft mirë që në orët e para të mëngjesit.



BRICJAPI

Megjithëse është një rrugë e gjatë për të arritur atë që keni planifikuar, e rëndësishme është që rezultati final do të jetë pozitiv.



UJORI

Edhe pse dukeni njeri i ftohtë, me ndjenjat do të zbuloni se jeni adoleshent dhe prekeni edhe për gjërat më të vogla.



PESHQIT

Sot do të jetë një ditë që do t'ju kujtojë diçka të dhimbshme. Megjithatë, do të dini ta rimerrni autokontrollin nga kujtimet.



'Dardanët' për fitore në Podgoricë

Futbollistët e Kosovës kanë paralajmëruar se të premtën ndaj Malit të Zi do të luajnë për fitore. "Kam plotësisht besim te djemtë tanë. Besoj fuqishëm se do të kemi gjasa të mëdha për ta fituar ndeshjen", ka thënë Fidan Aliti. Ndeshja Mali i Zi - Kosova është e vlefshme për kualifikueset në Kampionatin Evropian dhe zhvillohet të premtën nga ora 20:45



Besoj fuqishëm se do të kemi gjasa të mëdha për ta fituar ndeshjen", ka thënë Aliti. Kosova bën pjesë në Grupin A së bashku me Anglinë, Bullgarinë, Malin e Zi dhe Çekinë.

Jankoviqi: Ndaj Kosovës luajmë për tri pikë

Mesfushori malazez që aktivizohet te skuadra e Spalit në Itali, Marko Jankoviqi, ka bërë me dije se malazezët kërkojnë tri pikë, por kjo nuk do të jetë aspak e lehtë për t'u arritur. "Ata kanë sulm shumë të mirë, bëjnë presion të lartë. Nëse dimë të sulmojmë mirë në fillim dhe nëse lirohemi mirë nga topi prej vijës së fundit duke shkuar me pasime, do të krijojmë hapësira për sulmuesit. Për ta arritur këtë duhet përqendrim i madh dhe të luajmë qetë. Ne nuk kemi presion, edhe pse kundër nesh është një skuadër e fortë. Nuk do të ishte tragjedi nëse nuk marrim rezultatin që duam. Natyrisht se do të hyjmë në ndeshje për t'i marrë tri pikë", ka thënë Jankoviqi.

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të mërkurën e ka zhvilluar stërvitjen e fundit në Prishtinë dhe më pas ka udhëtuar drejt Malit të Zi. "Dardanët" të premtën e zhvillojnë ndeshjen kualifikuese për Kampionatin Evropian ndaj përfaqësueses malazeze, kurse optimizmi në kampin e Kosovës është i madh për këtë ndeshje shumë të rëndësishme.

Mali i Zi është më lart se Kosova në renditjen e FIFA-s, por kjo nuk e bregos aspak mbrojtësin e Standart Legies, Mërgim Vojvoda, që të kërkojë fitore në këtë ndeshje. "Nuk duhet ta shikojmë renditjen e FIFA-s, por duhet të

luajmë për t'i marrë tri pikë. Njëjtë vlen edhe kundër Anglisë që është brenda top 10-shës. Duhet të luajmë në çdo ndeshje pa frikë. Faktin që do të luhet ndeshja pa tifozë nuk di ta vlerësoj keq apo mirë për ne. Normalisht se çdo futbollist ka dëshirë të luajë në një stadium me shikues, por ndoshta malazezët do ta ndiejnë më shumë mungesën e shikuesve", ka thënë Vojvoda.

Para shkuarjes në Mal të Zi foli edhe kapiteni i Kosovës, Samir Ujkani, i cili vlerëson si shumë të vështirë ndeshjen që zhvillohet të premtën. Megjithatë, ai beson se skuadra e drejtuar nga Bernard Challandes mund të marrë pikë nga kjo ndeshje. "Ndeshja kundër Malit të Zi është një ndeshje e madhe dhe e vështirë,

por ne jemi përgatitur mirë dhe kemi punuar shumë. Atmosfera është e mirë dhe jemi në rrugë të mbarë. Por, tash mbetet që të premtën ta tregojmë veten dhe të nxjerrim rezultat pozitiv. Të gjithë po punojmë për njëri-tjetrin", ka thënë Ujkani, i cili në lidhje me mungesat e disa prej futbollistëve të rëndësishëm, ka shprehur besimin se kjo nuk do të krijojë probleme për faktin se në përfaqësues kanë ardhur futbollistë të rinj.

Mbrojtësi Fidan Aliti beson fuqishëm në fitore ndaj Malit të Zi, kurse për mungesën e

shikuesve është i mendimit se kjo i shkon përshtati Kosovës për faktin se luan si mysafire. "Kemi respekt për kundërshtarin, por ne i dimë kualitetet tona. Ndeshja në Podgoricë pa tifozë? Kam luajtur ndeshje të tilla me Skënderbeun në Ligën e Evropës. Është ndeshje e veçantë sepse çdo zë ndihet në fushë. Megjithatë, mund të jetë pozitiv sepse komunikimi mes lojtarëve është më i lehtë sepse s'ka zhurmë të shikuesve dhe kur e mendojmë se luajmë si mysafirë mund të jetë pozitive për ne. Kam plotësisht besim te djemtë tanë.

Presidenti Thaçi inkurajon femrat që të merren me sport



PRISHTINË, 5 QERSHOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë pjesë në manifestimin e Komitetit Olimpik të Kosovës për Ditën Botërore për Ambient dhe Sport. Në këtë ditë presidenti Thaçi i inkurajoi të gjitha femrat në Kosovë që ta ndjekin shembullin e Majlinda Kelmendit, Nora Gjakovës, Distria Krasniqit dhe shumë sportistëve të tjera që e kanë lartësuar flamurin e

Kosovës gjithkund në botë. "Ju duhet të besoni në aftësitë tuaja kreative, në përgatitjen tuaj, në mënyrë që t'i realizoni ëndrrat tuaja dhe aspiratat e shtetit të Kosovës për një imazh më të mirë", u shpreh presidenti Thaçi.

Në këta 11 vjet të pavarësisë kreu i shtetit ka thënë se sukseset më të mëdha në sport i kanë sjellë femrat, prandaj ky është një inkurajim shtesë që të

vazhdohet edhe më tej me sukseset e radhës. "Ky është një inkurajim shtesë që ju të merrni pjesë në jetën sportive dhe institucionet e Kosovës duhet të bëjnë më shumë që ju të arrini edhe më shumë suksese", ka thënë presidenti Thaçi.

Komiteti Olimpik i Kosovës, Ditën Botërore për Ambient dhe Sport sivjet ia ka kushtuar pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të femrave në sport.

MKRS-ja, 40 mijë euro për dy federata sportive

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në kuadër të mbështetjes financiare për federatat e sportit, ka nënshkruar sot memorandume bashkëpunimi edhe me dy federata sportive. Memorandumet u nënshkruan me Federatën e Bilardos së Kosovës dhe me Federatën e Muay Thai të Kosovës, të cilat u mbështetën me vlerë financiare 20 mijë

euro secila. Në bazë të këtyre memorandumeve, federatat janë të obliguara që këto mjete t'i shfrytëzojnë për realizimin e politikave të tyre programore. Ministri Gashi ka thënë se përkrahja financiare për këto federata sportive është në vazhdim e nënshkrimit të memorandumeve për përkrahjen financiare të federatave sportive të Kosovës. "Ne si Ministri i Sportit jemi të

përkushtuar që t'u krijojmë lehtësira federatave sportive në mënyrë që ato t'i realizojnë me suksese planet dhe objektivat e tyre për të sjellë rezultate në sportin kosovar", ka thënë ministri Gashi. Ndërkaq përfaqësuesit e këtyre federatave falënderuan ministrin Gashi për mbështetjen e vazhdueshme që u bëhet atyre si dhe sportit kosovar në përgjithësi.



Feronikeli 'blindon' 6 kampionë

DRENAS, 5 QERSHOR (ER) - Skuadra e Feronikelit arriti suksese të mëdha në edicionin 2018/2019 duke e fituar Kupën dhe titullin e kampionit. Kjo skuadër pas këtyre sukseseve do të marrë pjesë në garat ndërkombëtare, pra në parakualifikimet në Ligën e Kampionëve. Drejtuesit e klubit në

krye me kryetarin Naser Ramaj nuk kanë qëndruar duarkryq, pasi kanë rinovuar kontratat me gjashtë prej lojtarëve që ishin ndër më meritoret për sukseset e klubit. "Nikli" fillimisht vazhdoi kontratën me Yll Hoxhën, pastaj me Arbër Prekazin dhe sulmuesin më të mirë në ligë, Kastriot

Rexhën. Ndërsa më pas vazhdoi kontratat edhe me Përparim Islamit dhe Astrit Fazliun. I fundit që rinovoi me kampionët është anëtori Mendurim Hoti. Hoxha, Prekazi dhe Hoti kanë rinovuar edhe për dy sezone të tjera, kurse Rexha, Fazliu dhe Islami për një sezon tjetër.



Berisha: Vetëbesimi do të rritet me një rezultat pozitiv ndaj Islandës

TIRANË, 5 QERSHOR - Portieri i Kombëtares së Shqipërisë, Etrit Berisha, ka besim në një rezultat pozitiv ndaj Islandës. "Atmosfera mund të them se është e mirë. Kemi një trajner me përvojë të madhe dhe është munduar që ekipi të ketë entuziazëm. Tani për tani jemi të lumtur se si po kalojmë edhe në stërvitje edhe jashtë saj. Është e rëndësishme, por nuk duhet të kemi presion. Të gjithë ndeshjet janë të rëndësishme. Një rezultat pozitiv do t'i hapet shpresat për kualifikim. Jemi në një grup ku diferencat janë të vogla", ka thënë Berisha. "Sigurisht se po, mbi të gjitha, do të jetë edhe mirë për motivimin e ekipit. Luajmë ndaj një kundërshtari direkt për kualifikim dhe për moralin dhe vetëbesimin e ekipit do të thotë shumë. Do të mundohemi ta përgatisim sa më mirë këtë ndeshje dhe të shohim. I kemi kualitetet e duhura për të marrë një rezultat pozitiv. Lojtarët janë entuziastë dhe duan të shkojnë përpara. Të them të drejtën, tani për tani kemi mundësi të mira në mbrojtje. Kemi shumë lojtarë që mund ta kryejnë këtë repart mjaft mirë. Kemi lojtarë me përvojë dhe lojtarë që luajnë në kampionate të rëndësishme. Mund të them që në këtë repart jemi të konsoliduar mirë dhe shpresoj mos të kemi probleme", ka deklaruar Berisha. Portieri i Atalantës, Etrit Berisha, ka shprehur besimin se kombëtarja



kuqezit nuk do t'i përsërisë gabimet që i bëri në Ligën e Kombeve, pasi është mënyra e duhur për të marrë rezultate pozitive. Berisha është i bindur se një rezultat pozitiv në këtë ndeshje do t'i jepte edhe me shumë vetëbesim skuadrës për ndeshjet e radhës. "Të gjitha ndeshjet që kemi bërë, si në Ligën e Kombeve si tani, janë gati të të njëjtit nivel me ne dhe diferenca është bërë nga gabimet tona. Besoj se tani do t'i eliminojmë këto gabime që na kanë kushtuar. Nëse diçka e tillë ndodh do të kemi mundësi të marrim rezultate pozitive. Nuk dua të them do të marrim gjashtë, katër apo tri pikë. Nëse dalim mirë në këtë ndeshje do të kemi edhe shumë vetëbesim për ndeshjet e ardhshme. Mendoj se Islanda, përveç lojës në ajër, ka edhe kualitete të tjera. Gjithsesi, jemi në këtë periudhë ku e kemi në konsideratë këtë gjë. Po punojmë mjaft mirë për t'i bërë ballë Islandës", ka shtuar Berisha.

Rikthehet 'klasikja' Federer - Nadal

PARIS, 5 QERSHOR - Roger Federeri dhe Rafael Nadali do të vihen përballë njëri-tjetrit në gjysmëfinalen e turneut "Roland Garros" pas 14 vjetësh, për të zhvilluar atë që konsiderohet si "klasikja" e tenisit. Federeri u kualifikua pasi fitoi 3-1 derbin zviceran me Wawrinkën në çerekfinale. Pasi fitoi setin e parë 7-6, Federeri pa të humbasë të dytin 6-4. Por, ai mori veten dhe fitoi dy setet e tjera 7-6 dhe 6-4, duke i dhënë fund një ndeshjeje që pati një ndërprerje për shkak të motit, duke siguruar gjysmëfinalen e tij të 8 në "Roland Garros" dhe të 44-tën në total. Nadali nga ana e tij vazhdoi ta tregojë formën e tij shumë të mirë në këtë turne, të cilin kërkon ta fitojë për herë të 12. Spanjoli nuk pati mëshirë për Kei Nishikorin në çerekfinale dhe e mundi 3-0. Për 33-vjeçar, kjo është gjysmëfinalja e tij e 12 në "Roland Garros" dhe e 31-ta në të gjithë turnetë "Grand Slam". Nadali i mbylli dy setet e para 6-1 dhe 6-1, ndërsa në të



tretin ndeshja u ndërpre kur ai kryesonte 4-2. Me rikthimin në fushën e lojës, spanjoli e mbylli brenda 10 minutash këtë set me rezultatin 6-3. Edhe në kampin e femrave janë përcaktuar tenistet gjysmëfinaliste. Befasia e ka emrin Johana Konta që eliminoi amerikanen Sloan Stephens me rezultatin 2-0, me sete 6-1 dhe 6-4. Konta do të ketë si kundërshtarë të radhës Marketa Vondrousovan. Kjo e fundit mundi në dy sete kroaten Petra Martić. Çekja 20-vjeçare fitoi setin e parë me "tiebreak" 7-6, ndërsa të dytin e mbylli 7-5.

SHKURT

Interi, afër marrëveshjes me Xhakën

Skuadra e Interit është afër marrëveshjes me mesfushorin shqiptar Granit Xhaka. Lajmi është bërë me dije nga "RSI Sport". Besohet se trajneri i ri i Interit, Antonio Conte, me çdo kusht e dëshiron Xhakën në formacionin e tij. Aktualisht mesfushori është pjesë e Arsenalit, kurse më herët ka luajtur edhe për Borussia Monchengladbachun dhe Baseli.

Jamesi largohet përfundimisht nga Bayerni

